

Dita e dytë, 16 mars

Vendi: Hotel Emerald

10:00 - 10:55 Demokracinë nuk duhet ta marrim si të mirëqenë

Demokracia kërkon forcim dhe kujdes të vazhdueshëm dhe ndonëse ndonjëherë shfaqen mangësi, ajo funksionon dhe mundëson zhvillimin e shteteve në mënyrë paqësore. Megjithëse shtet i ri, demokracia në Kosovë po zhvillohet duke kontribuar në ndërtimin e një jete më të mirë për qytetarët e vendit. Mirëpo, demokracia sot po sulmohet në disa fronte globalisht dhe tani më shumë se kurrë populli i Kosovës duhet ta afirmojë dëshirën për premtimin e demokracisë. Në këtë bisedë të hapur, presidentja Osmani do të diskutojë me të pranishmit për gjendjen aktuale të demokracisë në vend, sfidat dhe mundësitë, si dhe lidhur me atë se si përfshirja e të gjithë zërave e bën demokracinë të qëndrueshme dhe triumfuese.

- Shkëlqesia e Saj Dr.Vjosa Osmani Sadriu, Presidente e Republikës së Kosovës
- Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

10:55 - 11:00 Mundësi për të bërë fotografi me Presidenten Osmani Sadriu

11:00 - 12:30 Llogaridhënia në qeverisje lokale: Adresimi i prioriteteve të qytetarëve përmes buxhetimit të përgjegjshëm gjinor

Angazhimi dhe përfaqësimi gjithëpërfshirës i qytetarëve në proceset e politikëbërjes janë qenësore për qeverisje të mirë. Për funksionimit e mirëfillët të demokracisë, në veçanti është e rëndësishme pjesëmarrja kuptimplotë e qytetarëve në nivel lokal. Garantimi i të drejtave, përgjegjësive dhe mundësive të plota dhe të barabarta për gratë dhe burrat, kërkon nga institucionet që të sigurohen që politikat, legjislacioni dhe buxheti auditohen duke marrë parasysh perspektivën gjinore. Ky panel diskutues synon të ekzaminojë gjendjen e llogaridhënies në nivel lokal në ofrimin e shërbimeve të përgjegjshme për të gjithë qytetarët, në veçanti për më të cenuarit.

- Donjeta Sahatçiu, Nënkyetare, Komuna e Prishtinës
- Marqe Tanushi Selmanaj, Nënkyetare, Komuna e Klinës
- Adnan Ademi, Kryesues i Kuvendit, Komuna e Shtimes
- Fatbardha Emini, Drejtore e Arsimit, Komuna e Vitisë

Moderatore: Rachel Weston, Specialiste për Politika Rajonale, Zyra Rajonale e UN Women për Evropë dhe Azi Qendrore

12:45 – 13:45 Dreka

14:00 – 14:20 Mbrojtja e demokracisë përmes gjithpërfshirjes

- Ambasadorja Melanne Verveer, Drejtore Ekzekutive, Instituti Georgetown për Gra, Paqe dhe Siguri, dhe ish Ambasadore për Çështjet Globale të Grave

14:20 - 16:00 “Dhjetë vjet nga Parimet e Prishtinës: Gati për përshejtim drejt barazisë gjinore”

Shoqëria kosovare ka shënuar progres në përfshirjen e më shumë zërave të grave në diskursin publik. Megjithatë, ende ka shumë për t'u bërë për të arritur barazinë gjinore. Parimet e Prishtinës shërbejnë si bazë dhe udhërrëfyes për përpjekjet lidhur me avancimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave në shoqëri. Gratë vazhdojnë të përballen me barriera të theksuara në të gjitha fushat - politike, sociale, kulturore, ekonomike dhe ligjore. Numri rekord i grave të zgjedhura dhe zhvillimet teknologjike paraqesin mundësi reference për panelin diskutues me synimin që të identifikohen mënyra për përshejtimin e barazisë gjinore për garantimin e fuqizimit politik dhe ekonomik të grave, si dhe sigurinë dhe drejtësinë e tyre në Kosovë.

- Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës (2011 – 2016)
- Tinka Kurti, Deputete dhe Kryetare e Bordit të Grupit të Grave Deputete, Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Artane Rizvanolli, Ministre, Ministria e Ekonomisë në Republikën e Kosovës
- Vlora Çitaku, Nënkyetare, Partia Demokratike e Kosovës
- Teuta Sahatqija, Anëtare e Kryesisë, Lidhja Demokratike e Kosovës

- Moderator: Visar Ymeri, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari

16:00 Fjala përmbyllëse dhe mbyllja

Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtore, NDI Kosovë